



Financuar nga
Bashkimi Evropian


center for
transparency
and freedom of
information

ema
EUROPEAN MOVEMENT ALBANIA

Raport

2025

RAPORT MONITORIMI, STRUKTURA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR (SPA), 2024



PUBLIKUES

QENDRA PËR TRANSPARENÇË DHE INFORMIM
TË LIRË (CTFI)

Adresa: Rr. Komuna e Parisit, Pal.2, Sh. 2,
Tirana, Albania

Tel: +355 682088602

E-mail: info@transparence.al

Web: www.transparence.al

VITI I PUBLIKIMIT:

2025

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE” , me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritetit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Hyrje	04
Organigrama	05
Buxheti	06
Investime të tjera	09
Ndryshimet në buxhet për vitin 2024	10
Krahasimi me vitet tjera	11
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	13
Të ardhura të realizuara nga institucioni	13
Fondet nga Granti (Eurojust)	14
Financimet nga institucione	14
Ndihmë, asistencë dhe aktive nga donatorë të huaj	15
Sekuestrimet dhe konfiskimet për vitin 2024	15
Parashikimi i risqeve që kanë lidhje me buxhetin	16

Kosto për njësi	16
Monitorimi i buxhetit	17
Prokurimet	18
Çështje të ngritura nga SPAK që kanë lidhje edhe më financimin	19
Volumi i hetimeve për 2024	20
Transparenca	21
Kompetencat e Komisionerit Publik transferohen në SPAK, impakti në buxhet	21
Gjetje dhe përfundime	22
Rekomandime	25
Bibliografia	26

Hyrje

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para gjykatës së posaçme, merr masa dhe mbikqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara me ligj.

SPAK është krijuar mbështetur në Kushtetutë [1] dhe ligjin nr. 95/2016 [2] ashtu si njësi e Posaçme Hetimore/Byroja Kombëtare e Hetimit e cila është krijuar sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 95/2016. Prokuroria e Posaçme kryen funksionet e saj në mënyrë të pavarur, nëpërmjet prokurorëve të posaçëm, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas një verifikimi dhe gare.

Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore, Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm, ndërkaq Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën për veprat si më poshtë:

Çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal.

Krimet e parashikuara nga Kodi Penal në Republikën e Shqipërisë si më poshtë: Neni 244 Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike; Neni 244/a Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë; Neni 245 Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor; Neni 245/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike; Neni 257 Përfitimi i paligjshëm i interesave; Neni 258 Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike; Neni 259 Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike; Neni 259/a Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë; Neni 260 Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë; Neni 312 Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit; Neni 319 Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë.

Akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendës ministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj.

SPAK nisi nga puna me 20 dhjetor të vitit 2019, me vetëm 8 prokurorë nga 20 të planifikuar. Sipas Kushtetutës, SPAK nuk mund të ketë më pak se 10 prokurorë, por nuk është përcaktuar numri maksimal i tyre. Prokuroria e Krimeve të Rënda që ka qenë parardhëse e SPAK-ut kishte 22 prokurorë.

[1] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, f.46

[2] Ligji nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"

Bazuar në nenin 18 ‘Numri i Përgjithshëm i Prokurorëve’ të ligjit të 17/2016, ‘Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë’, parashikohet se numri i përgjithshëm i prokurorëve në juridiksionin e përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Posaçme propozohet përkatësisht nga Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe miratohet nga Kuvendi.

Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në propozimin e numrit të prokurorëve, marrin paraprakisht mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

Prokurorët e SPAK kanë një mandat 9 vjeçar pa të drejtë ripërsëritje [3]. Drejtuesi i SPAK ka kërkuar dy herë në Kuvend ndryshimin e Kushtetutës në lidhje me mandatin e prokurorëve të SPAK duke hequr kufizimin vetëm me dy mandate duke u dhënë mundësi për një apo më shumë mandate të tjera por nëpërmjet përfshirjes në konkurrim.

Organigrama

Gjatë vitit 2024, në Prokurorinë e Posaçme kanë ushtruar detyrën 114 punonjës[1], nga të cilët 20 prokurorë të emëruar, 12 hetues financiarë, 80 punonjës administrativë dhe 2 punonjës me kontratë të përkohshme[2].

Gjatë vitit në shqyrtim janë punësuar 11 punonjës, nga të cilët: 3 punonjës janë emëruar me kontratë pune, nga të cilët: 1 Koordinator për Marrëdhënien me Mediat pranë Kabinetit të Drejtuesit, 1 Ekspert dhe 1 punonjës informacioni në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse; 8 punonjës të emëruar me procedura sipas ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, nga të cilët: 3 punonjës të emëruar me procedurën “pranim në shërbimin civil”, 2 punonjës të emëruar me procedurën “lëvizje paralele” dhe 3 punonjës të emëruar me procedurën “ngritje në detyrë”; 2 punonjës me kontratë pune, me kohëzgjatje 6 orë në ditë, me afat 1 vjeçar, në mbështetje të VKM nr. 39, datë 24.01.2024 “Për përcaktimin e punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes së qendrore”.

[3] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 148-dh

[4] Shpjegim: Ka mospërputhje në shifrat e të punësuarve në SPAK. Njëra shifër është ajo më sipër dhe tjetra si në vijim: Në total numri i punonjësve në SPAK në 2024 sipas dekretit ishte 133, 108 ishin efektive ndërsa kishte 25 vakanca. Te dyja shifrat janë marrë nga raporti vjetor i SPAK për vitin 2024

[5] Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), raporti vjetor 2024, f.14

Disa pozicione të paplotësuara ende, për shkak të kufizimeve logjistike (pamjaftueshmëria e ambienteve dhe zyrave) janë planifikuar të zhvillohen gjatë vitit 2025.

Për sa i takon BKH-së, struktura organizative e saj ka 138 pozicione pune, nga të cilët, 1 pozicion drejtori, 110 hetues dhe oficerë të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe 27 punonjës administrativë [6].

Gjatë vitit 2024 janë shpallur procedurat për 13 funksione administrative, nga të cilët: 4 funksione janë plotësuar dhe punonjësit administrativë kanë përmbushur edhe kushtin e sigurisë; për 5 funksione janë kryer procedurat e shërbimit civil, por kandidatët janë ende në proces verifikimi të kushteve të sigurisë; janë kryer procedurat e parashikuara për shërbimin civil për 4 funksione, por ato nuk kanë rezultuar me kandidatë fitues dhe janë anuluar.

Bazuar në strukturën aktuale, viti 2024 është mbyllur me disa vakanca: 1 në kabinetin e Drejtorit të BKH-së, 50 në pozicionet e shërbimeve të policisë gjyqësore, 40 hetues dhe 11 në stafin administrativ.

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka sipas planifikimit 9 punonjës, aktualisht janë 7 ndërsa ka 2 vakanca.

Buxheti

Buxheti [7] i akorduar për programin “Veprimtaria e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 1,901 milion lekë [8] dhe me buxhetin vjetor të rishikuar në vlerën 1,310 milion lekë [9].

Sipas planit të rishikuar shuma prej 1,042.000.000 lekë përfaqëson shpenzimet korente, dhe shuma 268.000.000 lekë shpenzimet kapitale.

Sipas realizimit faktik, totali i shpenzimeve të realizuara është në shumën 1,224,000,000 lekë ose 93% nga plani i rishikuar, nga të cilat shpenzimet korrente janë realizuar në vlerë 975 milion lekë, ndërsa shpenzimet kapitale në vlerë 249 milionë lekë.

[6] Urdhri i Përbashkët nr. 978 prot., datë 28.12.2023, të Drejtorit të BKH-se dhe nr. 1090/4, prot., datë 28.12.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për Organizimin e Brendshëm të Byrosë Kombëtare të Hetimit”

[7] Shënim: Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka kod institucioni në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë 1041001.Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) ka kod institucioni në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë 1041002.

[8] Ligji nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”

[9] Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2024)

Shpenzimet e personelit

Shpenzimi për paga është në vlerën e rreth 855.9 milion lekë ose rreth 65% e totalit të buxhetit të SPAK, nga të cilat Prokuroria e Posaçme në shumën 417.1 milion lekë dhe BKH në shumën 438.8 milion lekë.

Prokuroria e Posaçme ka realizuar 368.9 milionë lekë paga dhe 34.7 milionë lekë sigurime ose rreth 96% e shpenzimeve të planifikuara për vitin 2024; Byroja Kombëtare e Hetimit ka realizuar 380.3 milionë lekë paga dhe 28.6 milionë lekë sigurime ose 93% e shpenzimeve të planifikuara për vitin 2024 [10].

Bazuar në ndryshimet ligjore në vitin 2024 [11], sipas tepricave të fondeve buxhetore, janë pakësuar fondet në shumën totale 247 milion lekë [12] për zërin paga dhe sigurime.

Deklarimi i tepricave buxhetore ka qenë rrjedhojë e vakancave në dy institucionet, SPAK dhe BKH. Bazuar në ndryshimet ligjore në vitin 2024, i referohemi Aktit Normativ nr. 3 datë 28.08.2024 “Mbi ndryshimin e Ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” është marrë në konsideratë kërkesa e paraqitur nga SPAK për shtimin me 40 hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Kërkesa për shtimin e strukturës së Byrosë Kombëtare të Hetimit vjen si domosdoshmëri e rritjes së procedimeve penale, dhe volumit të punës.

Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera (602)

Gjatë 12 mujorit të vitit 2024, shpenzimi për zërin mallra dhe shërbime paraqitet në shumën 160.9 milion lekë, ose ndryshe 87 % të planit vjetor përfundimtar nga të cilat Prokuroria ka shpenzuar 158.2 milion lekë dhe BKH 2.7 milionë lekë.

Shpenzimet e kryera për të cilat janë përdorur fondet e planifikuara i referohen kryesisht mallra e shërbime sipas planifikimit në regjistrin e prokurimeve si shpenzimeve utilitare dhe procedurale. Rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023 ka ardhur për shkak se institucioni ka operuar në kushtet e rritjes së volumit të procedurave hetimore të zhvilluara si dhe shtesës së stafit për të dy institucionet [13].

[10] SPAK, raporti vjetor 2024

[11] Aktit Normativ nr. 3 datë 28.08.2024 “Mbi ndryshimin e Ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”

[12] Akti normativ nr. 5 datë 19.12.2024 “Mbi ndryshimin e Ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”

[13] SPAK, Raporti Vjetor 2024

Transferta për buxhete familjare

Për vitin buxhetor 2024, është planifikuar si Fond i Veçantë [14] (Llogaria 606) për mbulimin e rasteve të fatkeqësive, në shumën 350 mijë lekë.

Fondi i rishikuar për këtë zë është në shumën 984 mijë lekë dhe është shpenzuar shumën 984 mijë lekë, ose ndryshe 100 % të planit vjetor përfundimtar nga të cilat Prokuroria ka shpenzuar 924 mijë lekë dhe BKH 60 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024 janë ndërmarrë veprime për alokimin e burimeve dhe kërkesë për fond shtesë në shumën totale 809 mijë lekë [15] për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës.

Shpenzime për investime kapitale

Fondi i miratuar fillimisht për zërin investimet kapitale ka qenë në shumën 550 milion lekë [16]. Rrjedhojë e shtesave dhe pakësimeve, të reflektuara në buxhetin e miratuar, plani i rishikuar për zërin investimet kapitale është në shumën 268 milion lekë.

Gjatë 12 mujorit të vitit 2024, shpenzimi për këtë zë paraqitet në shumën 249.3 milion lekë, ose ndryshe 93 % të planit vjetor përfundimtar.

Përmes këtij fondi janë realizuar disa projekteve të rëndësishme:

Janë ngritur kapacitete operacionale dhe teknologjike [17] siç janë ambientet e sigurta dhe funksionale, pajisjen me teknologji të avancuar për hetimet dhe analizat forensike, si dhe krijimin e sistemeve të integruara të menaxhimit të informacionit dhe bazave të dhënave.

Gjatë vitit 2024, prokurimi i fondit të miratuar me objekt “Ndërtim dhe rikonstruksion për godinën e re të SPAK” sipas urdhër prokurimit të datës 13.08.2024, është anuluar për shkak të mosplotësimit të kriterëve nga operatorët ekonomik pjesëmarrës sipas përcaktimeve të Autoritetit Kontraktor.

[14] VKM nr.929, datë 17.11.2010 “Për Krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar

[15] VKM nr. 846 datë 26.12.2024 “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2024 për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës”

[16] Ligji nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”

[17] SPAK, raporti vjetor 2024 f.90

Kjo procedurë prokurimi është ri hedhur nga ana e Prokurorisë së Posaçme me urdhër prokurimin e datës 26.09.2024, procedurë e cila është anuluar për të njëjtat arsye, si më sipër [18].

Për shkak të afateve kohore të pamjaftueshme për përdorimin e fondeve të rialokuara lidhur me këtë investim për këtë vit buxhetor, u kërkua pakësim të fondeve buxhetore vitin 2024, e cila u reflektua në aktin normativ nr. 5 datë 19.12.2024.

Me aktin normativ nr. 5 dt. 19.12.2024 mbi ndryshimin e ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” bazuar në deklaratimet e tepricave të fondeve buxhetore për SPAK, është miratuar pakësim i fondeve në shumën 282 milion lekë për këtë zë.

Gjatë vitit 2024, pasuria e SPAK është shtuar me ndërtesën shtesë të prokurorisë ish-UKT me vlerë 744,178,250 si dhe inventari i zyrës së Komisionerëve Publikë ku përfshihen mobilje, veturë dhe inventar i imët në vlerën 4,606,611 lekë.

Investime të tjera [19]

Përfundimi i ngritjes së sistemit të administrimit të çështjeve (Case Management System) mbetet një prioritet për Prokurorinë e Posaçme. Sistemi ka një ndërtim modular dhe në dhjetor 2024 ka përfunduar zhvillimi/ndërtimi i moduleve.

Aktualisht është bërë e mundur vënia në funksion e këtij sistemi pothuajse në tërësinë e moduleve të tij (portali, protokoli, zyra e drejtuesit, prokurori, regjistri dhe hetuesi).

Për shkak të përfundimit të projektit mbështetës të ICITAP, ky proces është pezulluar dhe pritët të përmbillet brenda vitit 2025, me fonde të BE-së.

Brenda vitit 2025 parashikohet të përfundojë vënia në funksion edhe e moduleve të tjera si, raporte e statistika, regjistri i ekzekutimeve dhe regjistri i letër porosive, si dhe të fillojë zbatimin e sistemit elektronik të Menaxhimit të Çështjeve.

Rritja e kapacitetit të memories së sistemit të përgjimeve në BKH është një prioritet për të përballuar ngarkesën në rritje të sistemit që vijon edhe në vitin 2025.

[18] Po aty, f.91

[19] SPAK, raporti vjetor 2024 f.93

Ndërtimi i datacenterit të ri: një datacenter (dhome serverësh) me kushtet e duhura teknike është domosdoshmëri për mbarëvajtjen e punës të sistemeve qendrore të IT, për këtë qëllim në godinën e re është planifikuar një datacenter me standardet teknike, pajisjet e nevojshme dhe infrastrukturën e duhur të rrjeteve për të përmbushur qëllimin tu shërbejë punonjësve të godinës dhe në rast avarie të datacenterit të parë të përballojë ngarkesën e të dyja godinave.

Blerja e serverëvetë rinj së bashku me platformën e virtualizimit për të garantuar fuqi procesimi, memorie RAM të mjaftueshme për makinat virtuale që kërkohen për përballimin e stafit ekzistues.

Përmirësimi i kapacitetit të ruajtjes së të dhënave (storage): U mundësua ndërtimi i hapësirës për ruajtjen e të dhënave duke krijuar kapacitete me storage të rinj për data centerin e godinës së re në mënyrë që të mbështesë rritjen e volumit të dhënave që krijohen çdo ditë dhe për të mundësuar ruajtjen e tyre minimalisht në më shumë se një kopje duke garantuar sigurinë nga shkaqe të ndryshme si, dëmtimi fizik, sulme kibernetike, apo korrupsioni i të dhënave.

Ndryshimet në buxhet për vitin 2024

Me akt normativ në gusht 2024 ka pasur pakësim në zërat buxhetor me vlerë totale 87 milionë lekë dhe ndryshimi i numrit të punonjësve në organikë, shtesa prej 40 punonjës [20].

Me akt normativ në dhjetor 2024 janë bërë pakësime me vlerë totale 282 milionë lekë. Detajimet përkatëse janë reflektuar në muajin Dhjetor dhe lidhen me pamundësinë e zhvillimit të një tenderi për rikonstrukcionin e ndërtesës së re [21].

Ndryshimi i tretë lidhet me fondin e veçantë të prekur edhe më sipër i cili ka sjellë efekt rritës në shpenzime me vlerë totale 401 mijë lekë.

[20] Akti Normativ nr. 3, datë 28.08.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024"

[21] Akti Normativ nr. 5, datë 19.12.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024"

Krahasimi me vitet tjera

Buxheti ka pasur rritje duke filluar nga viti 2020 deri në vitin 2024. Kjo ka ndodhur për shkak se gjatë këtyre viteve janë shtuar kapacitetet njerëzore, përfshirë rekrutimin e prokurorëve dhe stafit mbështetës, investimet në teknologji dhe infrastrukturë, për të forcuar kapacitetet hetimore dhe sigurinë institucionale si dhe rritja e volumit të punës për shkak të numrit gjithnjë e më të madh të çështjeve të shqyrtuara.

Niveli i realizimit të fondeve është përmirësuar, nga 51% në vitin 2020 në 93% në vitin 2024.

Struktura e shpenzimeve gjatë këtyre viteve është pothuajse e pandryshuar. Kështu, shpenzimet korente përbëjnë mesatarisht 78-81% të totalit, duke reflektuar peshën e pagave, trajtimeve financiare dhe kostove operative të institucionit; shpenzimet kapitale ruajnë një nivel prej rreth 20% të totalit.

Peshën specifike më të lartë e zënë shpenzimet për paga dhe peshën specifike më të ulët e zënë transferta të tjera.

Me ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” buxheti i miratuar për SPAK është në vlerën 2,369 milion lekë. Shpenzimet për paga dhe sigurime në vlerën e rreth 1,421 milion lekë, ose 60% të buxhetit të miratuar, janë parashikuar sipas strukturës së miratuar për Prokurorinë e Posaçme dhe BKH. Për magjistrat, hetues financiar, hetues të BKH- së si dhe ekspertë, efekte të shtuara në shpenzimet për paga janë dhe orët e gatishmërisë dhe jashtë orarit zyrtar.

Projektbuxheti 2025 për Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar parashikohet në 2.17 miliardë lekë. Në seancën dëgjimore në Komisionin e Ligjeve, prokurori Alfred Shehu u shpreh se SPAK ka kërkuar buxhet shtesë për pagat, por edhe ndërtimin e godinës së re. “Në parashikimet buxhetore për këtë vit, edhe pse është reflektuar shqetësimi ynë lidhur me fondet buxhetore, sa i përket shpenzimeve kapitale, investimeve, konstatojmë që nuk janë marrë në konsideratë kërkesat shtesë lidhur me pagat, por gjithashtu do të ishte e nevojshme një plotësim i plotë i kërkesave në zërat e tjerë”. Ai u shpreh se në total diferenca nga kërkesa e SPAK me projektbuxhetin e miratuar është në shifrën 198.770.472 lekë [22].

Ndërkaq është marrë në konsideratë kërkesa e paraqitur nga SPAK për shtimin me 40 hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit me efekt 250 milionë lekë si dhe 11 punonjës shtesë në SPAK me efekt 54 milionë lekë.

Tab: Varianca e buxhetit nga viti 2020 kur nisi funksionimi i SPAK deri në vitin 2024

Viti	Buxheti i parashikuar/milionë lekë	Buxheti i realizuar/milionë lekë	Realizimi në %
2020	327,175	167,051	51%
2021	399,448	325,760	82%
2022	663,300	588,063	89%
2023	1,077,438	1,042,742	97%
2024	1,310,547	1,224,100	93%





Fig: Përqindja e realizimit të buxhetit në vite nga SPAK



Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, gjatë 12 mujorit të vitit buxhetor 2024 ka krijuar të ardhura jashtë limiti në vlerën totale 1,248 milionë lekë.

Të ardhura të realizuara nga institucioni

Të ardhurat të realizuara nga institucioni, ku kryesisht përfshihen tarifat për shpenzimet procedurale (fotokopje, skanime, CD, gjoba gjyqësore), janw në shumën 1,691,890 lekë.

Sipas udhëzimit të Prokurorisë së Posaçme Nr.613 datë 15.09.2023 “Për shpenzimet procedurale të Prokurorisë” ato janë derdhur në buxhetin e shtetit në fund të vitit[1].

[23] Udhëzimit i Prokurorisë së Posaçme Nr.613 datë 15.09.2023 “Për shpenzimet procedurale të Prokurorisë”

Fondet nga Granti (Eurojust)

Gjatë viti 2024, Për Prokurorinë e Posaçme është akorduar një fond në shumën totale 1,247,711 lekë bazuar sipas Programit të financimit të Ekipeve të Përbashkëta Hetimore (EPH-ve) i Eurojust-it. Shpenzimet operative të kryera nga Financimet e EUROJUST janë shpenzime procedurale të cilat lidhen me çështje të skuadrave të përbashkëta hetimore. EUROJUST rimbursen deri në 95% të shpenzimeve lidhur me këto procedime penale, kryesisht për përkthim të akteve, akomodim, udhëtim [24].

Financimet nga institucione:

SPAK është mbështetur nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), e cila ka dhënë fonde sipas kërkesës së SPAK për blerjen e pajisjeve dhe sistemeve të sigurisë, pajisjeve elektronike për zhvillimin e hetimeve, etj.

Nëpërmjet Kontratës së protokolluar me nr.1189, datë 30.03.2023, për Prokurorinë e Posaçme është miratuar një Grant në shumën 169,208,320 lekë, me burim nga AAPSK me objekt: “Blerje të pajisjeve dhe sistemeve elektronike për rritjen e sigurisë kibernetike dhe sistemit teknologjik për sigurinë e hetuesve në terren”.

Nga ky fond për vitin 2024 janë realizuar procedurat në shumën totale 47.9 milionë lekë ose rreth 28% nga plani total, e cila është prokuruar në disa lote:

- “Blerje sistem mbrojtje antiransomware, storage, server” realizuar në shumën 17.5 milionë lekë
- “Blerje sisteme sigurie, monitorimi dhe akses kontrolli” realizuar në shumën 3.7 milionë lekë
- “Blerje server” realizuar në shumën 22.6 milionë lekë.
- “Blerje sistem sigurie antivirus” realizuar në shumën 4 milionë lekë
- “Blerje Sistem dhe pajisje të teknikës operative” në shumën totale 121.2 milionë lekë, është anuluar si pasojë e skualifikimit të gjithë operatorëve ekonomikë. Procedura do zhvillohet në vitin 2025.

Diferenca e mbetur nga viti 2024 në vlerën 121.2 milionë është trashëguar për vitin 2025 [25].

[24] SPAK, raporti vjetor 2024 f.94

[25] Po aty f.103

Ndihmë, asistencë dhe aktive nga donatorë të huaj

Totali i donacioneve për SPAK për vitin 2024 është 5,174,072 lekë.

Misionet ndërkombëtare, si ICITAP, OPDAT dhe EU4LEA, kanë sjellë ekspertizë dhe burime të vlefshme për të mbështetur implementimin e sistemeve të avancuara dhe përmirësimin e infrastrukturës IT, si dhe për të fuqizuar kapacitetet e analizës dhe menaxhimit të dhënave.

Ka patur aktdhurime nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Fondacioni Spanjoll “Internacional Y Para Iberoamerika de Administraciony Politicas Publicas”. Departamenti i USA ka sjellë një ‘Forensic Workstation - Talino KA-301’ me vlerë 3,598,221 lekë dhe po nga Departamenti i USA laptop 898,625 lekë.

Ndërkaq fondacioni spanjoll ka sjellë pajisje dhe orendi zyre në vlerën 677,226 lekë.

Sekuestrimet dhe konfiskimet për vitin 2024

Janë sekuestruar dhe konfiskuar pasuri të paluajtshme, vlera monetare, kuota tregtare, si dhe portofole kriptovalutash në një vlerë totale prej rreth 65,5 milion eurosh.

Vlera e pasurive të sekuestruara për 2024 është 2,800,705,512 lekë, ndërkohë që vlera e pasurive të konfiskuara arrin në shumën rreth 36,7 milion euro.

Kështu, vlera e pasurive të sekuestruara zë rreth 43,8% të vlerës totale, ndërsa pasuritë e konfiskuara zënë rreth 56,2% të vlerës totale.

Krahasuar gjithashtu me vitin 2023, vihet re një rritje në masën rreth 59,7% e vlerës totale të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (rreth 65,5 milion euro në vitin 2024 kundrejt rreth 41 milion euro në vitin 2023).

Pasuri të sekuestruara: 28 milionë euro

Pasuri të konfiskuara: 36 milionë euro

Totali: 64 milionë euro

Parashikimi i risqeve që kanë lidhje me buxhetin

SPAK ka miratur strategjinë e institucionit për vitet 2024-2027. Në analizën e riskut strategjia ka llogaritur si një risk të ulët mundësinë e reduktimit të kapaciteteve financiare të institucionit. “Ulja e buxhetit dhe pengesa të ndryshme të karakterit financiar në përmbushjen e nevojave të Prokurorisë së Posaçme”, është përkufizimi i këtij risku i cili parashikohet me nivel të ulët [26]. Si masë parandaluese parashikohet shpjegimi i hollësishëm i nevojave të prokurorisë në takimet në Kuvend dhe në KLP; mundësia e riorganizimit të buxhetit duke vendosur prioritete sipas strategjisë.

Kosto për njësi


Kosto për njësi produkti në këtë rast ‘dosje të përfunduara’ llogaritet si shpenzime korente të pjestuara për numrin total të dosjeve të përfunduara në vitin buxhetor. Shpenzimet korente në SPAK kanë qenë 1,351,063,000 lekë. Në këtë shumë futen artikujt buxhetorë, 600, 601, 602, 606 përkatësisht pagat, sigurimet shoqërore, mallrat dhe shërbime, transfertat për buxhetet familjare dhe individët. Ndërsa çështjet e përfunduara kanë qenë 220. Kosto për një çështje për 2024 është 6,141,195 lekë.

Tab: Kosto për produktin ‘dosje të përfunduar’ në vitet 2021-2024


Viti/nr i çështjeve	Buxheti/lekë	Kosto për dosje të përfunduar/lekë
2021/226	299,528,000	1,325,345
2022/196	568,712,900	2,901,596
2023/ 193	1,034,304,000	5,359,088
2024/220	1,351,063,000	6,141,195 lekë

[26] SPAK, plani strategjik 2024-2027 f.23

SPAK/ Evolucion i koston për dosje të përfunduar (2021-2024)



SPAK/ Evolucion i koston për dosje të përfunduar (2021-2024)



Monitorimi i buxhetit

Buxheti i SPAK përgaditet përmes 3 momenteve kryesore: Përgaditja e PBA në fazën e parë deri më 30 prill. Në këtë fazë përcaktohet buxheti duke u nisur nga realizimet e një viti më parë. Ndërsa për dy vitet e tjera ka një përshtatje me strategjinë por gjithnjë duke patur për bazë vitin parardhës.

Në fazën e dytë kryesisht në korrik dhe gusht, bëhen specifikimet e shpenzimeve me tavanet. Ndërsa faza e tretë ndodh nëse Ministria e Financave nuk aprovon buxhetin në masën që kërkohet dhe i drejtohet Kuvendit. Kjo ka ndodhur në rastin e fondit të pagave në vitin 2023.

Grupi i Menaxhimit Strategjik, GMS, mbledhet të paktën 4 herë në vit. Buxheti i BKH menaxhohet nga SPAK, në pjesën më të madhe të tij ndërkohë që BKH ka një njësi që menaxhon shpenzimet. Në vitin 2025 SPAK merr edhe funksionet e komisionerit të KPK, duke apeluar sa herë të shikojë të nevojshme vendimarrjen për vetingun që do të kryhet në vijim nga KLGJ dhe KLP për të gjitha ata magjistratë që nuk e kanë mbyllur vettingun deri në dhjetor të vitit 2024. Janë parashikuar 10 këshilltarë ligjorë me një impakt në buxhet prej 53 milionë lekësh.

Në lidhje me raportet me Ministrinë e Financave ka një përplasje mes SPAK dhe kësaj ministrie për shkak të pagesave të orëve jashtë orarit dhe gadishmërisë të cilat parashikohen me VKM 568 'datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore'. Efekti në buxhet i këtyre pagesave është 40 milionë lekë dhe parashikohen deri në 200 orë shtesë në vit.

Prokurimet

Për vitin 2024, në Regjistrin e Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit janë parashikuar 25 procedura prokurimi për zërin Shpenzime Mallra Shërbime dhe 11 procedura prokurimi për zërin Investime Kapitale.

Ndërsa në regjistrin e realizimit të procedurave të prokurimit janë gjithsej 61 prokurime. Diferenca vjen nga mënyra e raportimit të ndryshëm në dy regjistrat [27].

Parashikimi për procedurat e prokurimit ishte në vlerën 166 milionë ose 75% e buxhetit total për shpenzimet operative, ndërsa shpenzimet kapitale ishin parashikuar në vlerën 268 milionë.

Nga Marrëveshjet Kuadër të mbartura nga vitit 2023 janë realizuar 6 procedura prokurimi, nga e cila janë lidhur 28 kontrata me vlerë 14.3 milionë lekë.

Nga Marrëveshje Kuadër të vitit 2024 janë realizuar 7 procedura prokurimi, nga e cila janë lidhur 14 kontrata sipas lotëve përkatëse me vlerë 10.2 milionë lekë.

Nga procedurat me kontratë të vitit 2024 janë realizuar 18 procedura prokurimi me vlerë 129.4 milionë lekë.

Nga procedurat për investimet të vitit 2024 janë realizuar 10 procedura prokurimi me vlerë 251 milionë lekë.

[27] Regjistri i parashikimit të prokurimit publik , 2024; Regjistri i realizimit të prokurimit publik 2024

Ka raste kur ndonjë zë mosrealizimi është i madh edhe pse bëhet fjalë për forcim të kapaciteteve të SPAK. Për shembull tek produkti 'Blerje pajisje operationale dhe të teknikës operative', plani vjetor i blerjeve ka qenë 9.000.000 lekë. Ky plan është rishikuar në vlerën 72.000 lekë dhe ndërkohë nuk është realizuar fare

Shpenzimet rezultojnë më të ulëta në muajin janar me 4.4% dhe shënojnë nivelin më të lartë në muajin dhjetor me 32 % të totalit.

Shpenzimet më të mëdha janë për mirëmbajtjen e sistemeve (përgjimi dhe ekspertiza), të pasuara nga shpenzime për shërbime utilitare (energji elektrike, ujë, telefoni, internet etj.) dhe shpenzime për likuidimin e faturave të shërbimeve të ofruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që përbën edhe zërin e tretë me më shumë shpenzime.

Në shpenzimet operative janë kryer pagesa avokatësh, ekspertësh dhe përkthyesish, taksa, shpenzime për blerje materiale të ndryshme kancelarie, materiale pastrimi, karburant, shpenzimet për mirëmbajtje transporti, shpenzime për mirëmbajtje godine, etj.

Nga një krahasim mes viteve 2020-2024 konstatohen kursime nga procedurat e prokurimit mes fondit limit dhe fondit të prokuruar:

- Për vitin 2020 është 306,663 lekë me TVSH.
- Për vitin 2021 është 1,324,568 lekë me TVSH.
- Për vitin 2022 është 4,914,331 lekë me TVSH.
- Për vitin 2023 është 2,297,604 lekë me TVSH.
- Për vitin 2024 është 53,574,648 lekë me TVSH.

Fondi limit në total i kursyer për procedurat e investimeve për periudhën 2020-2024 është 62,417,814 lekë me TVSH [28].

Çështje të ngritura nga SPAK që kanë lidhje edhe më financimin

Në raportin vjetor të SPAK për vitin 2024 theksohet 10 problematika në fusha të ndryshme të veprimtarisë së këtij institucioni, ku 4 prej tyre lidhen me shpenzimet.

Sipas raportit vjetor të SPAK nuk janë akorduar këshilltarë ligjorë pranë Prokurorisë së Posaçme çfarë cenon cilësinë e hetimit dhe prapësimeve të SPAK në ndjekjen e çështjeve në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në Gjykatën Kushtetuese; Përfundimi i ngritjes së sistemit të administrimit të çështjeve (Case Management System) mbetet një prioritet për Prokurorinë e Posaçme. Sistemi ka një ndërtim modular dhe në dhjetor 2024 ka përfunduar zhvillimi/ndërtimi i moduleve.

Për shkak të përfundimit të projektit mbështetës të ICITAP, ky proces është pezulluar dhe pritet të përmbyllet brenda vitit 2025, me fonde të BE-së; nevoja për një njësi të analizës së SPAK që do të shpërbejë për të mbështetur hetimet komplekse, matjet e riskut, dhe raportimet në kuadër të negociatave me BE, Moneyval dhe raportime në kuadër të strategjive kombëtare të ndryshme; Vijnë të mbetet problematike statusi i specialistit Ndërlidhës në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta, i cili trajtohet si nëpunës civil bazuar në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar. Kjo situatë është në kundërshtim me funksionet, që duhet të kryejë Specialisti Ndërlidhës sipas ligjit nr. 95/2016, siç është argumentuar në raportin vjetor të SPAK, për vitin 2023.

Volumi i hetimeve për 2024

Volumi i hetimeve penale është rritur me 9,7% krahasuar me vitin paraardhës. Kështu gjatë kësaj periudhe, janë nën hetim gjithsej 793 procedime (në 854 procedime nën hetim gjithsej, 61 prej tyre janë bashkuar).

Prej këtij totali, 526 procedime penale janë mbartur nga viti 2023, ndërsa 328 procedime penale janë regjistruar gjatë vitit 2024, si procedime penale të reja.

Ka rritje të kërkesave për ndihmë juridike në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar me 45,8% për ato të ardhura nga jashtë vendit dhe me 34,7%, për ato drejtuar autoriteteve të huaja.

Volumi i ekspertizës

Gjatë vitit 2024 në Sektorin e Ekspertizës kanë ardhur për ekspertim 400 vendime ekspertimi për 841 prova digjitale dhe konkretisht për 553 telefona celularë dhe tabletë, 110 kompjutera, 16 DVR dhe 162 prova të tjera digjitale (hard disqe, USB, karta memorie, CD/DVD, etj.), kjo krahasuar me vitet më parë është në rritje.

Transparenca

Gjatë vitit 2024 SPAK miratoi Strategjinë e Komunikimit me Publikun duke ndjekur praktika të aplikuara nga agjencitë ligj zbatuese të ngjashme me SPAK-un. “Strategjia e Komunikimit 2025-2028” mbështetet nga dy dokumente të tjerë; Strategjia për Median Sociale, ku përfshihen qasja për komunikimin në; Facebook dhe X; Protokolli i Komunikimit gjatë Krizave, një dokument që do të përdoret nga Prokuroria e Posaçme për të menaxhuar krizat si dhe për të shmangur dëmet afatgjata, që do të cenonin funksionimin dhe reputacionin e institucionit.

Janë regjistruar 128 kërkesa për informacion nga qytetarë, media, organizata të shoqërisë civile dhe subjekte të ndryshme për vitin 2024. Ato kanë marrë përgjigje të plotë dhe brenda afateve ligjore nga Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat.

Kërkesat për informacion dhe përgjigjet janë përfshirë në “Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve”[29]. Numri i informacioneve të klasifikuara sekret është 1132.

Raportet e monitorimit të buxhetit janë publikuar në faqen zyrtare të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, vetëm ato për 4 mujorin dhe 8 mujorin, por jo raporti 12 mujor. Ky i fundit u publikua pas kërkesës për informacion nga ana e CTFL. Janë publikuar regjistri i parashikimeve të prokurimeve dhe ai i realizimit të prokurimeve.

SPAK ka zhvilluar disa konferenca për shtyp si dhe ka mbajtur takime periodike me gazetarët e kronikës, jashtë kamerave “off the record”, ku është diskutuar për çështjet më të rëndësishme.

Kompetencat e Komisionerit Publik transferohen në SPAK, impakti në buxhet

Kreu i SPAK ka marrë kompetencat e komisionerëve të pavarur publikë në procesin e vetingut duke nisur nga 1 janari i vitit 2025 [30]. Aktualisht janë 41 çështje që kanë mbetur për tu gjykuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit të cilat angazhojnë Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme të ndjekë rreth 150-200 seanca gjyqësore, në harkun kohor janar 2025-qershor 2026, numër që mund ndryshojë në varësi të kompleksitetit të çështjeve.

[29] SPAK, plani strategjik 2024-2027 f.23

[30] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenit 179/b, pika 8; Ligji nr. 16/2022 “Për një ndryshim në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në kuadër të këtij procesi është aprovuar [31] për vitin 2025, një periudhë jo më shumë se gjashtë muaj, për të finalizuar procesin e mbylljes së veprimtarisë administrative të Komisionerit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik. Një pjesë e numrit të punonjësve administrativë të këtyre institucioneve sipas vendimit të Kuvendit qëndruan në detyrë dhe ishin pjesë e programit buxhetor të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor të Ministrisë së Drejtësisë.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi organikën dhe klasifikimin e pagave të punonjësve të administratës (në total 15 punonjës) pas mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë, si pjesë e arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor të Ministrisë së Drejtësisë, vendim i cili hyn në fuqi në datë 01.01.2025 deri në datë 30.06.2025.

Gjetje dhe rekomandime

Buxheti i SPAK për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 1,901 milion [32] lekë dhe me buxhetin vjetor të rishikuar në vlerën 1,310 milion lekë.

Sipas planit të rishikuar shuma prej 1,042.000.000 lekë përfaqëson shpenzimet korrente, dhe shuma 268.000.000 lekë shpenzimet kapitale.

Buxheti është realizuar në shumën 1,224,000,000 lekë ose 93% nga plani i rishikuar, të cilat shpenzimet korrente janë realizuar në vlerë 975 milion lekë, ndërsa shpenzimet kapitale në vlerë 249 milionë lekë.

Zëri i shpenzimeve për paga është në vlerën e rreth 855.9 milion lekë ose rreth 65% e totalit të buxhetit të SPAK.

Gjatë vitit 2024, prokurimi i fondit të miratuar me objekt “Ndërtim dhe rikonstruktion për godinën e re të SPAK” është anuluar dy herë për shkak të mosplotësimit të kriterëve nga operatorët ekonomik në garë.

Niveli i realizimit të fondeve në vite është përmirësuar, nga 51% në vitin 2020 në

93% në vitin 2024. Struktura e shpenzimeve gjatë këtyre viteve është pothuajse e pandryshuar; shpenzimet korente përbëjnë mesatarisht 78-81% të totalit, duke reflektuar peshën e pagave, trajtimeve financiare dhe kostove operative të institucionit; shpenzimet kapitale ruajnë një nivel prej rreth 20% të totalit.

[32] Ligji nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”

Për vitin 2025 buxheti i miratuar për SPAK është në vlerën 2,369 milion lekë. Shpenzimet për paga dhe sigurime në vlerën e rreth 1,421 milion lekë, ose 60% të buxhetit të miratuar, janë parashikuar sipas strukturës së miratuar për Prokurorinë e Posaçme dhe BKH. Për magjistrat, hetues financiar, hetues të BKH- së si dhe ekspertë, efekte të shtuara në shpenzimet për paga janë dhe orët e gatishmërisë dhe jashtë orarit zyrtar.

Gjatë vitit 2024, në Prokurorinë e Posaçme kanë ushtruar detyrën 114 punonjës [33], nga të cilët 20 prokurorë të emëruar, 12 hetues financiarë, 80 punonjës administrativë dhe 2 punonjës me kontratë të përkohshme [34].

Disa pozicione nuk u plotësuan në vitin 2024 për shkak të kufizimeve logjistike (pamjaftueshmëria e ambienteve dhe zyrave).

BKH ka 138 pozicione pune, nga të cilët, 1 pozicion drejtori, 110 hetues dhe oficerë të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe 27 punonjës administrativë. Viti 2024 është mbyllur me mbi 100 vakanca: 1 në kabinetin e Drejtorit të BKH-së, 50 në pozicionet e shërbimeve të policisë gjyqësore, 40 hetues dhe 11 në stafin administrativ.

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka sipas planifikimit 9 punonjës, aktualisht janë 7 ndërsa ka 2 vakanca.

Është marrë në konsideratë kërkesa e paraqitur nga SPAK për shtimin me 40 hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit me efekt 250 milionë lekë si dhe 11 punonjës shtesë në SPAK me efekt 54 milionë lekë .

Buxheti ka pasur rritje duke filluar nga viti 2020 deri në vitin 2024. Niveli i realizimit të fondeve është përmirësuar, nga 51% në vitin 2020 në 93% në vitin 2024.

Struktura e shpenzimeve gjatë këtyre viteve është pothuajse e pandryshuar. Kështu, shpenzimet korente përbëjnë mesatarisht 78-81% të totalit; shpenzimet kapitale ruajnë një nivel prej rreth 20% të totalit.

Peshën specifike më të lartë e zënë shpenzimet për paga dhe peshën specifike më të ulët e zënë transferta të tjera.

Me ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” buxheti i miratuar për SPAK është në vlerën 2,369 milion lekë ose 23 milionë euro, ndryshe rreth 4 milionë euro më shumë se planifikimi i vitit 2024. Për magjistrat, hetues financiarë, hetues të BKH- së si dhe ekspertë, efekte të shtuara në shpenzimet për paga janë dhe orët e gatishmërisë dhe jashtë orarit zyrtar.

[33] Shpjegim: Ka mospërputhje në shifrat e të punësuarve në SPAK. Njëra shifër është ajo më sipër dhe tjetra si në vijim: Në total numri i punonjësve në SPAK në 2024 sipas dekretit ishte 133, 108 ishin efektivë ndërsa kishte 25 vakanca. Te dyja shifrat janë marrë nga raporti vjetor i SPAK për vitin 2024

[34] Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), raporti vjetor 2024, f.14

Janë sekuestruar dhe konfiskuar pasuri të paluajtshme, vlera monetare, kuota tregtare, si dhe portofole kriptovalutash në një vlerë totale prej rreth 65,5 milion eurosh.

Vlera e pasurive të sekuestruara për 2024 është 2,800,705,512 lekë, ndërkohë që vlera e pasurive të konfiskuara arrin në shumën rreth 36,7 milion euro.

Kështu, vlera e pasurive të sekuestruara zë rreth 43,8% të vlerës totale, ndërsa pasuritë e konfiskuara zënë rreth 56,2% të vlerës totale.

Krahasuar gjithashtu me vitin 2023, vihet re një rritje në masën rreth 59,7% e vlerës totale të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara (rreth 65,5 milion euro në vitin 2024 kundrejt rreth 41 milion euro në vitin 2023).

Në analizën e riskut strategjia ka llogaritur si një risk të ulët mundësinë e reduktimit të kapaciteteve financiare të institucionit: “Ulja e buxhetit dhe pengesa të ndryshme të karakterit financiar në përmbushjen e nevojave të Prokurorisë së Posaçme”. Kosto për një çështje për 2024 është 6,141,195 lekë, ose 800 mijë lekë më e lartë se në vitin 2023.

Në vitin 2025 SPAK merr edhe funksionet e komisionerit të KPK, duke apeluar sa herë të shikojë të nevojshme vendimarrjen për vetingun që do të kryhet në vijim nga KLGJ dhe KLP për të gjitha ata magjistratë që nuk e kanë mbyllur vettingun deri në dhjetor të vitit 2024. Janë parashikuar 10 këshilltarë ligjorë me një impakt në buxhet prej 53 milionë lekësh.

Në lidhje me raportet me Ministrinë e Financave ka një përplasje mes SPAK dhe kësaj ministrie për shkak të pagesave të orëve jashtë orarit dhe gatishmërisë të cilat parashikohen me VKM 568 ‘datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore’. Efekti në buxhet i këtyre pagesave është 40 milionë lekë dhe parashikohen deri në 200 orë shtesë në vit.

Shpenzimet rezultojnë më të ulëta në muajin janar me 4.4% dhe shënojnë nivelin më të lartë në muajin dhjetor me 32 % të totalit.

Shpenzimet më të mëdha janë për mirëmbajtjen e sistemeve (përgjimi dhe ekspertiza), të pasuara nga shpenzime për shërbime utilitare (energji elektrike, ujë, telefoni, internet etj.) dhe shpenzime për likuidimin e faturave të shërbimeve të ofruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që përbën edhe zërin e tretë me më shumë shpenzime.

Në shpenzimet operative janë kryer pagesa avokatësh, ekspertësh dhe përkthyesish, taksa, shpenzime për blerje materiale të ndryshme kancelarie, materiale pastrimi, karburant, shpenzimet për mirëmbajtje transporti, shpenzime për mirëmbajtje godine, etj.

Kursimet nga procedurat e prokurimit mes fondit limit dhe fondit të prokuruar për vitin 2024 është 53,574,648 lekë me TVSH.

Nuk janë akorduar këshilltarë ligjorë pranë Prokurorisë së Posaçme çfarë sipas SPAK cenon cilësinë e hetimit dhe prapësimeve të SPAK në ndjekjen e çështjeve në të gjitha shkallët e gjyimit dhe në Gjykatën Kushtetuese; Përfundimi i ngritjes së sistemit të administrimit të çështjeve (Case Management System) mbetet një prioritet për Prokurorinë e Posaçme. Për shkak të përfundimit të projektit mbështetës të ICITAP, ky proces është pezulluar dhe pritet të përmbyllet brenda vitit 2025, me fonde të BE-së; nevoja për një njësi të analizës së SPAK që do të shpërbejë për të mbështetur hetimet komplekse, matjet e riskut, dhe raportimet në kuadër të negociatave me BE, Moneyval dhe raporte në kuadër të strategjive kombëtare të ndryshme; Vijon të mbetet problematike statusi i specialistit Ndërlidhës në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta, i cili trajtohet si nëpunës civil bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar. Kjo situatë është në kundërshtim me funksionet, që duhet të kryejë Specialisti Ndërlidhës sipas ligjit nr. 95/2016.

Kreu i SPAK ka marrë kompetencet e komisionerëve të pavarur publikë në procesin e vettingut duke nisur nga 1 janari i vitit 2025 [35]. Aktualisht janë 41 çështje që kanë mbetur për tu gjykuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit të cilat angazhojnë Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme të ndjekë rreth 150-200 seanca gjyqësore, në harkun kohor janar 2025-qershor 2026, numër që mund ndryshojë në varësi të kompleksitetit të çështjeve.

Rekomandime

Kuvendi të shqyrtojë dhe të mbështetë financiarisht nevojat e SPAK për këshilltarë ligjorë.

Të sigurojë paraprakisht mbështetje me fonde për përfundimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në mungesë të një financimi nga BE.

Të sigurojë mbështetje financiare për SPAK në lidhje me nevojën për një njësi analize.

Kuvendi në bashkëpunim me qeverinë dhe ministrinë e Financave të adresojë problematikën që lidhet me statusin e specialistit ndërlidhës në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta, i cili aktualisht trajtohet si nëpunës civil pasi kjo situatë është në kundërshtim me funksionet, që duhet të kryejë Specialisti Ndërlidhës.

SPAK të shmange vonesat në prokurime dhe investime për shkak të mungesës së kontraktorëve duke përpiluar thirrjet për tender në mënyrë transparente, sipas nevojave dhe kërkesave të institucionit duke synuar një spektër sa më të gjerë të garës.

[35] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenit 179/b, pika 8; Ligji nr. 16/2022 “Për një ndryshim në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Bibliografia

Legjislacioni dhe Akte Ligjore

- Akti Normativ nr. 3 datë 28.08.2024 “Mbi ndryshimin e Ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”
- Akti normativ nr. 5 datë 19.12.2024 “Mbi ndryshimin e Ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 179/b, pika 8
- Ligji nr. 16/2022 “Për një ndryshim në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar
- Ligji nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitin 2023”, i ndryshuar
- Ligji nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”
- Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar
- Ligji nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”
- Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar
- Ligji nr. 115/2024, për “Buxhetin e vitit 2025
- Ligji nr. 119/2014- Për të drejtën e informimit, i ndryshuar
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
- Udhëzimi Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
- Udhëzim i Prokurorisë së Posaçme Nr.613 datë 15.09.2023 “Për shpenzimet procedurale të Prokurorisë”
- VKM nr. 846 datë 26.12.2024 “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2024 për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës”
- VKM nr.929, datë 17.11.2010 “Për Krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar

Analizë dokumentesh për institucionin e monitoruar

- Raporti vjetor 2024, 2023, 2022 SPAK
- Raport vjetor i monitorimit të SPAK, 2024, 2023 CTFI
- Regjistri i parashikimit të prokurimit publik , 2024
- Regjistri i realizimit të prokurimit publik 2024
- SPAK, Plani Strategjik 2024-2027 f.23

Burime të tjera

- Armand Shahini, Drejtori i Buxhetit dhe Financës, SPAK, 2 korrik 2024/25 korrik 2025
- Informacion dërguar Këshillit Kombëtar të Integritetit Europian në Kuvend nga ana e drejtuesit të SPAK më 26.03.2024
- Rreshka, Përgjegjëse e Buxhetit, 22 korrik 2025
- <https://www.youtube.com/watch?v=mwXOj4Vkn8>